




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.07, datë 11.04.2024



PËR

**RINOVIMIN E LEJES SË PËRDORIMIT TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK, ME
NR.PROT. 64/2 DATË 16.10.2017 DHËNË ME VENDIM NR.58
DATË 10.10.2017 NGA KBU SHKUMBIN,,
SUBJEKTIT “DRINI BULQIZË”**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik, me nr.prot. 64/2 datë 16.10.2017 dhënë me vendim nr. 58 datë 10.10.2017 nga KBU Shkumbin,, subjektit “Drini Bulqizë”,nëpërmjet HEC Polemi me vendndodhje në degëzimet e përroit të Neshtës degë e zallit të Kostenjës Librazhd Qarku Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:
HEC Polemi

Vepra e marrjes 1

- X = 522461.3; Y = 4578039.3; Z = 1050 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja mesatare $Q_{mes} = 0.18 \text{ m}^3/\text{s}$

- Prurja llogaritëse $Q_{\text{llog}} - 0.14 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike $Q_{\text{eko}} - 0.0105 \text{ m}^3/\text{s}$

Vepra e marrjes 2

- $X = 521645.6$; $Y = 4577757.8$; $Z = 1050 \text{ m.m.n.d. (KRGJSH)}$
- Prurja mesatare $Q_{\text{mes}} - 0.282 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja llogaritëse $Q_{\text{llog}} - 0.16 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike $Q_{\text{eko}} - 0.0119 \text{ m}^3/\text{s}$

Vepra e marrjes 3

- $X = 521552.9$; $Y = 4576684.7$; $Z = 1050 \text{ m.m.n.d. (KRGJSH)}$
- Prurja mesatare $Q_{\text{mes}} - 0.222 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja llogaritëse $Q_{\text{llog}} - 0.26 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike $Q_{\text{eko}} - 0.0189 \text{ m}^3/\text{s}$

Godina e Centralit

- $X = 522937.3$; $Y = 4576390.7$; $Z = 655 \text{ m.m.n.d. (KRGJSH)}$
- Sasia e ujit që jepet në përdorim: $0.56 \text{ m}^3/\text{s}$
- Vëllimi i rrjedhës së kthyer: $0.56 \text{ m}^3/\text{s}$

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

MAJLINDA PERRI

